

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1255 Prot.

Tiranë, më 29.04.2022

VENDIM QARKULLUES

Nr. 35 , datë 29.04.2022

**“PËR MIRATIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE TË HAPJES SË PROGRAMEVE
TË PËRBASHKËTA NË FAKULTETIN E MJEKËSISË, DENTARE TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË ME UNIVERSITETIN E CHIETIT-
PESCARA, ITALI”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”: neni 3 pika 4/c, neni 35, neni 49, neni 80; të Statutit të UMT-së: neni 51, neni 95; të Vendimit nr. 40, datë 29.04.2022 të Senatit Akademik “Për miratimin e hapjes së programeve të përbashkëta të studimit Master Ekzekutiv në “Implanto Protetikë” dhe Master Profesional në “Higjienë Dentare dhe Terapi Parodontale jo Kirurgjikale” në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë me Universitetin Chieti-Pescara, Itali”, Bordi i Administrimit i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të miratojë efektet financiare të hapjes së programeve të përbashkëta Master Ekzekutiv në “Implanto Protetikë” dhe Master Profesional në “Higjienë Dentare dhe Terapi Parodontale jo Kirurgjikale” në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë me Universitetin Chieti-Pescara, Itali.
2. Efektet financiare të hapjes së programeve të përbashkëta (sipas pikës 1), përballohen nga të ardhurat e Fakultetit të Mjekësisë, Dentare, UMT.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Fakultetit të Mjekësisë, Dentare, UMT dhe strukturat përkatëse të UMT-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETAR

ZAMIR AGJINI

ANËTARË

MONIKA FIDA

VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJENOPULLI

ANIS THODHORJANI

ENDRIT YZEIRAJ